Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1005

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " INFINITT " SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material dhe paisje të TI-së" me numër të prokurimit 941-23-11685-1-2-1, me 08/03/2024, mori:

Vendim

1.Aprovohet pjesërishte bazuarankesa e OE" INFINITT " SH.P.K. e datës 11/12/2023 me nr.protokolli 2023/1005,lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material dhe paisje të TI-së", me numër të prokurimit 941-23-11685-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA, kurse,

2.Vërtetohet, Vendimi i Autoritetit Kontraktues UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA, i datës 20.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 24.10.2023, UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me material dhe paisje të TI-së" me numër të prokurimit 941-23-11685-1-2-1. Ndërsa me datën

20.11.2023 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 27.11.2023, OE " INFINITT " SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 29.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE " INFINITT " SH.P.K. me Nr. protkolli 1005/23 lidhur me aktivitetin "Furnizim me material dhe paisje të TI-së" me numër të prokurimit 941-23-11685-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Pretendimet e operatorit ekonomik ankuesOE " INFINITT " SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se "AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit te ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP. AK/ Zyra e prokurimit me 20.11.23 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku ka rekomanduar për kontrate OE i renditur me çmim i dyti për këtë aktivitet te prokurimit. Oferta jone megjithëse ishte oferta me e lire e dorëzuar për këtë aktivitet te prokurimit nuk është përzgjedhur si oferte e suksesshme nga AK. AK/ zyra e prokurimit na është drejtuar me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm letër e cila iu drejtohet operatoreve ekonomik te cilët kane plotësuar te gjitha kriteret dhe specifikimet teknike por nuk kane qene oferta me e lire e dorëzuar. Ne këtë mënyrë AK ka vepruar jashtëligjshëm duke mos respektuar nenin 54 te LPP-se, citoj: 1. Kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt. Njoftimi i tillë duhet që së paku të përmbaje informatat të cilat shpjegojnë arsyet përkatëse në përputhshmëri me: 1.1. në rast të eliminimit të kandidatit, njoftimi do të shpjegojë arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati. 1.2. në rast të eliminimit të një tenderuesi që është eliminuar për shkak të parregullsive ose përndryshe tenderit të papërshtatshëm, njoftimi do të saktësojë mungesat në një tender të tillë. 1.3. në rast të një tenderuesi të pa-suksesshëm, që ka paraqitur tender të përgjegjshëm, njoftimi do të saktësojë karakteristikat dhe përparësitë përkatëse të tenderit fitues si dhe emrin e tenderuesit fitues. AK ne rast se ka eliminuar kompaninë tone për te shpërblyer me kontrate OE i renditur i dyti me çmim, është dashur te na drejtohet me letër standarde për tenderuesin e eliminuar duke shpjeguar arsyejet për eliminim e jo letër për tenderuesin e pasuksesshëm. Ne te kundërtën nëse komisioni ka vlerësuar ofertën tone si oferta e përgjegjshme me çmimin me te ulet dhe nuk jemi rekomanduar për kontrate AK ka vepruar jashtëligjshëm dhe nuk ka respektuar dispozitat ligjore bazike te LPP-se/ Neni 52, 60. Me 22.11. kemi kërkuar qasje ne dokumente zyrtare dhe AK na ka ofruar qasjen me 23.11. Nga dokumentet te cilat i kemi pranuar ne qasjen ne dokumentet

zyrtare konstatojmë se AK ka rekomanduar për kontrate OE te papërgjegjshëm i cili ne baze te broshurave/modelet te ofruara nuk plotëson specifikimet teknike për pozicionet 11 dhe 18 si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit. AK ne përgjigje te kërkesës për ri-shqyrtim përsëri nuk sqaron arsyejen e eliminimit për kompaninë tone por thekson se ne raportin e vlerësimit mund te shihni arsyejet për eliminim. Raporti I vlerësimit nuk është ngarkuar ne e-prokurim si dhe nuk na është dërguar bashkangjitur me vendimin për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim. Ne këtë mënyrë AK qëllimisht është duke e fshehur te vërtetën ne mënyrë qe ne heshtje pa dëshmi te vërtetuara/fakte ligjore te eliminoje ofertën e kompanisë sonë dhe te shpërblejë me kontrate OE te preferuar. Ne kemi rishikuar dokumentet e ofertës te cilat kemi dorëzuar ne ofertim dhe verifikuam se oferta jone plotëson te gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit si dhe kemi dorëzuar broshure për te gjitha produktet sipas kërkesës se AK ne ANEKS 1. Specifikimet teknike te detyrueshme. Shkelje tjetër e ndodhur ne këtë aktivitet te prokurimit është se AK pas pranimit te kërkesës për ri-shqyrtim nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit konform pikës 2 te nenit 108/a te LPP-se. Prandaj bazuar ne konstatimet e lartcekura konstatojmë se zyra e prokurimit pranë Uni Kadri Zeka dhe komisioni vlerësues për projektin ne fjale nuk kane respektuar dispozitat ligjore esenciale te LPP ne fuqi dhe kane diskriminuar kompaninë tone duke mos shpërblyer me kontrate edhe pse kemi qene oferta e përgjegjshme me çmimin me te ulet për këtë aktivitet te prokurimit.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE “" INFINITT " SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 52, 54, 59, 60 dhe 108/A të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje e AK - UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE "INFINITT " SH.P.K. – refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim pasi që nuk qëndron në pikat të cilat janë atakuar. Oferta juaj ka qenë më e lirë por nuk i ka përmbushur specifikat teknike dhe ka qenë e pa përgjegjshme. Njoftimi për të gjithë Operatoret Ekonomik është bërë edhe përmes B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK. Të gjitha sqarimet për pikat në të cilat jeni ankuar janë raportin e vlerësimit të ofertave. Oferta e Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë është e bazuar edhe në Rregulloren e Prokurimit Publik, respektivisht neni 40.6 pikat A, B dhe C. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i plotëson të gjitha specifikimet teknike edhe nga pika 11 dhe 18.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 18.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2023/1005 ndërsa me datë 30.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1005 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, kurse të mbetet në fuqi vendimi i AK.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është deklaruar se pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertin shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar se “njoftoj se nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues ne përjashtim te përgjigjes ne pretendimin ankimor nr. 1.Eksperti shqyrtues ndoshta ka pasur qasje ne raportin e vlerësimit ku janë elaboruar ne detaje arsyejet e eliminimit te ofertës sonë, ky pikërisht ka qene pretendimi ankimor kryesor i kompanisë sonë pasi qe AK nuk ka dërguar letrën standarde për tenderuesin e eliminuar konform pikës 1 te nenit 54 te LPP-se po ashtu ne e-prokurim nuk është ngarkuar raporti i vlerësimit te

ofertave si dhe pas kërkesës për ri-shqyrtim AK nuk na ka dërguar arsyejet për eliminim, prandaj kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-se qe te ktheje lenden ne ri-vlerësim dhe AK/ komisioni vlerësues ne rast se eliminon ofertën e kompanisë sonë te na drejtohet me letër standarde për tenderuesin e eliminuar e jo te pasuksesshëm, rrjedhimisht pas pranimit te arsyejeve për eliminimin e ofertës sonë nëse kemi baze ligjore për ankese lindin pretendime ankimore kundrejt te cilave mund te parashtrojmë ankese te detajuar. Nuk bën te lejohet te vazhdohet te ndiqet kjo praktike nga Zyra e prokurimit pranë AK Uni Kadri Zeka qe OE te eliminuar ti drejtohet me letër standarde për OE te pasuksesshëm. Ky nuk është gabim teknik por praktike te cilën çdoherë aplikon zyra e prokurimit pranë Uni Kadri Zeka".

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Pra, Paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE" INFINITT " SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1005 ka vlerësuar si në vijim:

Lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë me çështjen e mos njoftimit nga ana e AK për OE, eksperti shqyrtues, pas administrimit të dokumentacionit të prezantuar në e-prokurim, vëren se AK ka vepruar në kundërshtim me Ligjin LPP nr. 04/L-042, nenin 54, si dhe rregulloren nr. 001/2022 për prokurim publik. Sipas dispozitave ligjore të përcaktuara më lartë, AK do të duhej të vepronte në përputhje me nenin 54, pikat 1 dhe 1.1. "Kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt. Njoftimi i tillë duhet të përmbajë të paktën informatat e nevojshme për të shpjeguar arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati." Prandaj, lidhur me këtë çështje, pretendimi ankimore i OE ankues kundër veprimeve të AK ËSHTË I BAZUAR, edhe pse duke theksuar qe ky lëshim teknik i AK nuk ka ndikuar ne rezultatin apo vlerësimin përfundimtar te kësaj procedure prokurimi.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues kundër vendimit të AK në lidhje me mosplotësimin e kërkesës me nr. 8 nga ana e OE ankues, mund të theksohet se pas administrimit të dokumentacionit të prezantuar në ofertën e OE ankues, eksperti shqyrtues vërehen se, në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike në Aneks 1 të DT, është kërkuar një Printer për etiketa (labela) portable me karakteristikat e caktuara (Ekran LCD, Tastier QERTY, Gjersi maksimale e shiritit 12mm, 10 Fonte (stile të tekstimit), shtypje vertikale, bateri 6xAAA, adapter për mbushje, 180dpi print resolution). Ndërsa OE ankuesi ka ofertuar pajisjen Brother PT-P900W, e cila nuk i plotëson kërkesat e DT, pasi nuk ka ekran LCD dhe tastierë QERTY, dhe se nuk është në kategorinë e printereve portable të kërkuar sipas kërkesave të DT. Prandaj, bazuar në sqarimin e mësipërm, pretendimi ankimor i OE ankues kundër vendimit të AK në këtë çështje sipas ekspertit është I PA BAZUAR.

Në lidhje me pretendimin ankimor për pikën 13 kundër vendimit të AK, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar, eksperti shqyrtues sqaron se vërehet se AK ka vepruar me të drejtë në

këtë kërkesë, pasi pajisja e ofruar nuk përmbush kërkesën e DT, sepse nuk është në rangun 125kHz deri në 13.56MHz. Përkatësisht, konform dokumentit të prezantuar në ofertë dhe pas kërkimit në internet, pajisja e ofruar (no brandName) është vetëm për brezin 125kHz. Prandaj, bazuar në sqarimin e mësipërm, pretendimi ankimor i OE ankues kundër vendimit të AK në këtë çështje sipas ekspertit është i PA BAZUAR.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues kundër vendimit të AK rreth rekomandimit për kontratë për OE Pattern SHPK, sa i përket mosplotësimit të kërkesave teknike, pas administrimit të dokumentacionit të ofruar, eksperti shqyrtues mendon se:Në pikën 11, sipas kërkesave të DT, është kërkuar një pajisje me karakteristikat e caktuara (5 Button: Laser, Right, Left, start presentation, black screen; 2.4Ghz wireless; 50 foot wireless range; 2xAAA batteries; no software). OE i rekomanduar për kontratë, bazuar në dokumentacionin e pajisjes së ofruar në lidhje me këtë kërkesë të DT, ka ofertuar pajisjen MS POINT O100, e cila, pas shqyrtimit të katalogut dhe kërkimit në internet (shih linkun https://manualzz.com/doc/72587820/ms-point-o100-wireless-laser-presenter-user-manual), përmbush kërkesat dhe ka të gjitha funksionet, duke përfshirë edhe funksionin black screen. Prandaj, bazuar në sqarimin e mësipërm, pretendimi ankimor i OE ankues kundër vendimit të AK në këtë çështje është i PA BAZUAR.

Në lidhje me pretendimin ankimor që ka të bëjë me pikën 18 të aneksit 1 në DT, vlen të theksohet se në këtë pikë (18) është kërkuar një sprej për pastrim elektronik (sprej për pastrim të kontakteve të pllakave dhe gjërave tjera elektronike, që janë pjesë e motherboard apo pllakave tjera elektronike, specifika tjera: të jetë ideal për përdorim në circuit boards, controls, switches, precision instruments and electric panels). Lidhur me këtë, OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar produktin KONTAKT PRF 6-68, i cili, sipas katalogut dhe të dhënave në internet (shih linkun https://www.distrelec.de/en/contact-cleaner-spray-can-165ml-prf-68-220-kontakt-nordic/p/18081523), është një produkt që përdoret për pastrim të kontakteve elektronike. Prandaj, pretendimi ankimor i OE ankues kundër vendimit të AK në këtë çështje është i PA BAZUAR**.**

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues është i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik si dhe përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material dhe paisje të TI-së" me

numër të prokurimit 941-23-11685-1-2-1, pasi që është vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore (nuk është gjetur ndonjë shkelje mbi të cilat ka pretenduar OE ankues me rastin e parashtrimit te ankesës në OSHP) përjashtimit faktit që AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 54 LPP, si dhe rregulloren nr. 001/2022 për prokurim publik ku përcaktohet se "Kurdo që një autoritet kontraktues e eliminon një kandidat ose tenderues nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit, autoriteti i tillë kontraktues duhet që menjëherë të njoftojë kandidatin ose tenderuesin me shkrim mbi këtë fakt. Njoftimi i tillë duhet të përmbajë të paktën informatat e nevojshme për të shpjeguar arsyet për refuzimin e kërkesës për pjesëmarrje të atij kandidati." Paneli Shqyrtues vlerëson se ky është një lëshim teknik i AK i cili nuk ka ndikuar në rezultatin apo vlerësimin përfundimtar të kësaj procedure prokurimi, megjithatë kërkohet nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe të mos kalohet në një praktikë të tillë në të ardhmen.

Mbi bazën e lartcekurave i lejohet Autoriteti Kontraktues që të vazhdoj tutje me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si me sipër ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore për prokurimin publik.

Paneli Shqyrtues konsideron përfundimisht se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk është vërtetuar se përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1 të LPP. Për më tepër ësht konstatur se Oferta e ankuesit nga aspekti teknik i kërkuar nuk i plotëson kriteret e evndosura në dosjen e tenderit, sepse sipas eksperitit pas administrimit të dokumentacionit të prezantuar në ofertën e OE ankues, është konstauar , në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike në Aneks 1 të DT, është kërkuar një Printer për etiketa (labela) portable me karakteristikat e caktuara (Ekran LCD, Tastier QERTY, Gjersi maksimale e shiritit 12mm, 10 Fonte (stile të tekstimit), shtypje vertikale, bateri 6xAAA, adapter për mbushje, 180dpi print resolution). Ndërsa OE ankuesi ka ofertuar pajisjen Brother PT-P900W, e cila nuk i plotëson kërkesat e DT, pasi nuk ka ekran LCD dhe tastierë QERTY, dhe se nuk është në kategorinë e printereve portable të kërkuar sipas kërkesave të DT., duke cituar me tej edhe arsye tjera eliminuse pa nevojë që të njejtat të përshkruhen sërish ne detaje.

Paneli sqaron po ashtu se në vështrim të kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat precizohen në dosjen e tenderit dhe si të tilla bëhen publike për të gjithë ofertuesit eventual, natyrisht se secili duhet të udhëhiqet nga parimi i kujdesit në përmbushjen e kushteve formale në kohë dhe brenda afatit. Andaj Paneli Shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" kur ka refuzuar ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat

relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur konform nenit 31 pika 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP. si në pikën 3 të këtij dispozitivi, Paneli vendosi të kthejë tarifën e paguar për ankesë, për arsye se eksperti konstatoi se mungesa e njoftimit zyrtar për eliminimin e OE-së shkel Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) dhe rregulloren për prokurim publik. Neni 54 i LPP dhe pikat 1 dhe 1.1 të rregullores vendosin detyrimin e Autoritetit Kontraktues (AK) për të njoftuar OE-në nëse ata janë eliminuar nga pjesëmarrja në tender. Edhe nëse mungesa e njoftimit nuk ka ndikuar në rezultatin përfundimtar të tenderimit, kjo vazhdon të shkelë ligjin dhe dyshon integritetin e procesit. Prandaj, vendimi i panelit për të kthyer tarifën ankimore bazohet në faktin se AK ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke e bërë këtë hap të rëndësishëm për sigurimin e barazisë dhe transparencës në tenderime. Pra, pretendimi ankimore është cilësuar i bazuar në detyrimet ligjore dhe kthimi i tarifave është një masë e rëndësishme për sigurimin e trajtimit të barabartë të ofertuesve.Andaj paneli shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri LPP dhe Rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën OSHP nga kuadri i paneleve shqyrtuese, ka të drejtë që të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **UNIVERSITETI PUBLIK KADRI ZEKA**
- OE - **" INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: